



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 1 gusht 2017

Ref. Nr: 155/013

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 82, 21 tetor 2010), neneve 5 dhe 24 të Ligjit nr. 04/L032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17/16, shtator 2011), dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet zbatimi i dokumenteve "*Korniza e Kurikulës së Kosovës*", "*Kurikulat Bërtham*" dhe "*Programet mësimore*" në Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës për vitin shkollor 2017/2018.
2. Aprovohet zbatimi i programeve mësimore: Klasa përgatitore (0), klasa parë (1), klasa gjashtë (6), klasa dhjetë (10) për gjimnaze në të gjitha shkollat e Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe hyn në fuqi për zbatim në vitin shkollor 2017/2018.
3. Të gjitha Drejtoritë Komunale për Arsim dhe të gjitha shkollat e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës bëjnë përgaditjet për zbatim në shkolla, të programeve mësimore sipas *Kornizës së Kurikulës së Kosovës*, në vitin shkollor 2017/2018.
4. Përgaditjet përfshijnë:
 - 4.1. Informimin dhe senzibilizimin e komunitetit arsimor të shkollës me programe të reja lëndore;
 - 4.2. Riorganizimin e organeve profesionale të shkollës;

- 4.3. Përcaktimin e mësimdhënësve që do të punojnë me klasët të përcaktuar në pika 2 për zbatimin e programit mësimor;
- 4.4. Përgaditjet e planit vjetor, periodik, mujor, javor dhe ditor, në zbatim të programit mësimor për klasë.
5. Me zbatimin e programit mësimor për klasët: 0, 1, 6, 10 për gjimnaze në shkollë, shfuqizohen programet mësimor të deritashme për këto kasë.
6. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamentet e Divizionet përgjegjëse të MASHT-it për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsy e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë, kërkesës me nr. 8/2-2682 të dt. 26.07.2017 dhe pas realizimit të zbatimit të vendimit për nënshkrim dhe finalizimin e dokumentit, i cili proces ka qenë rezultat i zbatimit të programit mësimor në 95 shkolla të Kosovës, nga koordinatorët e MASHT-it, koordinatorët e DKA-ve për kurrikula, koordinatorët e cilësisë në shkolla, prindërit, trajnerët, nga projekti mbështetës i GIZ, nga vizita e shkollave pilotuese dhe nga raportet të propozimeve të hartimit të programeve lëndore, u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

Arsim BAJRAMI, ministër

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Iu dërgohet:

- Sekretarit të përgjithshëm, MASHT;
- Departamentit për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar/MASHT;
- Departamentit për Politikat e Arsimit Parauniversitar/MASHT;
- Departamentit të Inspektimit të Arsimit/MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Arsimin Parauniversitar/MASHT;
- Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve/MASHT;
- Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve/MASHT;
- Divizionit për Planprogrameve dhe Teksteve Shkollore/MASHT;
- Drejtorive Komunale të Arsimit
- Arkivit/MASHT.